



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1696/Prot
3

Tiranë, më 12/11/2019

VENDIM

Nr. 32, datë 12.11.2019

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1696 Prot., datë 25.10.2019, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Këlcyrë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 02.10.2019, depozituar në adresën elektronike info@bashkiakelcyre.gov.al ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me projektin “Rijetëzimi i pedonaleve dhe krijimi i hapësirave rekreative në sheshin qendër” Këlcyrë, konkretisht:

1. Kush është autoriteti për ndërmarrjen dhe hartimin e nismës së projektit “Rijetëzimi i pedonaleve dhe krijimi i hapësirave rekreative në sheshin qendër” Këlcyrë?
2. Klasifikimin e projektit bazuar në legjislacionin përkatës.
3. Shpjegim mbi parimet e ndjekura dhe të zbatuara në hartimin e projektit. Shpërndarja e të drejtave të zhvillimit në mënyrë të drejtë dhe propocionale, si është aplikuar në hartimin e projektit mbi pronat private të ndaluara për zhvillim, të shpjeguar në detaje.
4. Kur është miratuar projekti, data, numri i vendimit dhe organi miratues.
5. Referuar letrës së Bashkisë Këlcyrë drejtuar z. _____ me nr. port. 502, datë 7.3.2018, cila është baza ligjore (neni, ligji, organi miratues i ligjit) që Bashkia Këlcyrë mbështet njoftimin për mosklasifikim të mëtejshëm për zhvillim

të objektit lokal plus banesë të z.

në zonën e lulishtes qendër,

Kërcyrë?

6. *Cili është vendimi, data e KRRT së Bashkisë Kërcyrë, për miratimin e studimit urbanistik pjesor për zonën e brendshme, pronë publike të lulishtes qendër Kërcyrë, me hartues arkitekt ? Një kopje të studimit të miratuar.*
7. *Cila është procedura e plotë ligjore që autoriteti i hartimit dhe miratimit të projektit ka ndjekur nga fillimi deri në fund të projektit. Një kopje të procedurës së ndjekur.*
8. *Cili është dokumenti teknik i përfitimit të zhvillimit/dokumentit i fizibilitetit të projektit?*
9. *Si ka vepruar Bashkia Kërcyrë lidhur me ndërtimin e paligjshëm në zonën e lulishtes qendër, Kërcyrë? Mbi çfarë parimesh hartuesi i projektit nuk ka vepruar mbi ndërtimin e paligjshëm në hartimin e projektit?*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur fillimisht ankimin nr. 1696 Prot., datë 25.10.2019 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njih ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1696/1 Prot, datë 01.11.2019, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni.

Në vijim, me shkresën nr. 2340 Prot., datë 06.11.2019, administruar me tonën nr. 1696/2 Prot., datë 08.11.2019, Autoriteti Publik ka kthyer pjesërisht përgjigje duke sqaruar ndër të tjerat se: *"...Përsa i përket kërkesës së ankimuesit, i gjithë informacioni dhe dokumentet përkatëse i janë referuar organit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, pasi për këtë objekt ankese pala ankimuese ka kryer padë pranë organit të gjykatës. Me vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është rrëzuar pjesërisht kërkesë padia e ankimuesit lidhur me kundërshtimin e projektit "Rijetëzimi i pedonaleve dhe krijimi i hapësirave rekreative në sheshin qendër" Kërcyrë dhe i është pranuar nga ana e Gjykatës vetëm kërkesa për dëmshpërblim të pronës së tij. Gjithashtu ky shtetas ka kryer disa herë ankesa lidhur me këtë objekt ankese dhe nga ana e Bashkisë Kërcyrë i është kthyer përgjigje."*

Duke qenë se detyrimi nuk është përmbushur, ankuesi ka vijuar me ankimin datë 06.11.2019, me pretendimin se: *"Autoriteti Publik në përgjigjen e sipërcituar nuk ka vënë në dispozicion asnjë informacion/dokumentacion në lidhje me kërkesat objekt ankese"*.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Pavarësisht se nga ana e Autoritetit Publik bëhet me dije se, i gjithë informacioni/dokumentacioni i është referuar organit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, në funksion të procesit gjyqësor, kjo nuk e legjitimon këtë të fundit për mos vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se, disa nga kërkesat e z. Jani bëjnë pjesë në atë kategori informacioni që, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duhet të jenë të publikuara në Programin e Transparencës së Autoritetit Publik si dhe t’i vihen në dispozicion publikut pa kërkesë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Ekzistenca e dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, ngarkon me përgjegjësi, këtë të fundit për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Theksojmë gjithashtu se, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka për qëllim të nxisë përfundimisht integritetin, transparencën e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, konkretisht, Neni 15 “Transparenca e veprimtarisë së njërive të vetëqeverisjes vendore”, në të cilin parashikon se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikum transparencën e veprimtarisë së tyre.”*

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. _____ ndaj Bashkisë Këlcyrë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1696 Prot., datë 25.10.2019 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Këlcyrë”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit të kërkuar, në lidhje me projektin “Rijetëzimi i pedonaleve dhe krijimi i hapësirave rekreative në sheshin qendër” Këlcyrë, konkretisht:
 1. Kush është autoriteti për ndërmarrjen dhe hartimin e nismës së projektit “Rijetëzimi i pedonaleve dhe krijimi i hapësirave rekreative në sheshin qendër” Këlcyrë?
 2. Klasifikimin e projektit bazuar në legjislacionin përkatës.
 3. Shpjegim mbi parimet e ndjekura dhe të zbatuara në hartimin e projektit. Shpërndarja e të drejtave të zhvillimit në mënyrë të drejtë dhe propocionale, si është aplikuar në hartimin e projektit mbi pronat private të ndaluara për zhvillim, të shpjeguar në detaje.
 4. Kur është miratuar projekti, data, numri i vendimit dhe organi miratues.
 5. Referuar letrës së Bashkisë Këlcyrë drejtuar z. _____ me nr. port. 502, datë 7.3.2018, cila është baza ligjore (neni, ligji, organi miratues i ligjit) që Bashkia Këlcyrë mbështet njoftimin për mosklasifikim të mëtejshëm për zhvillim të objektit lokal plus banesë të z. _____ në zonën e lulishtes qendër, Këlcyrë?
 6. Cili është vendimi, data e KRRT së Bashkisë Këlcyrë, për miratimin e studimit urbanistik pjesor për zonën e brendshme, pronë publike të lulishtes qendër Këlcyrë, me hartues arkitekt _____? Një kopje të studimit të miratuar.
 7. Cila është procedura e plotë ligjore që autoriteti i hartimit dhe miratimit të projektit ka ndjekur nga fillimi deri në fund të projektit. Një kopje të procedurës së ndjekur.
 8. Cili është dokumenti teknik i përfitimt të zhvillimit/dokumenti i fizibilitetit të projektit?
 9. Si ka vepruar Bashkia Këlcyrë lidhur me ndërtimin e paligjshëm në zonën e lulishtes qendër, Këlcyrë? Mbi çfarë parimesh hartuesi i projektit nuk ka vepruar mbi ndërtimin e paligjshëm në hartimin e projektit., brenda datës 19.11 .2019.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 12.11 .2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

